



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.37

2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9498 datë 3.4.2006	Për disa ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	1159
Ligj nr.9499 datë 3.4.2006	Për disa ndryshime në ligjin nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.....	1160
Ligj nr.9506 datë 3.4.2006	Për një ndryshim në ligjin nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar.....	1160
Ligj nr.9507 datë 3.4.2006	Për disa ndryshime në ligjin nr.9075, datë 29.5.2003 “Për miratimin e kritereve dhe termave kryesorë të zgjidhjes së borxhit të jashtëm të trashëguar, të papaguar të Shqipërisë”	1161
Ligj nr.9508 datë 3.4.2006	Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit.....	1162
Ligj nr.9509 datë 3.4.2006	Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë.....	1166
Dekret nr.4848 datë 21.4.2006	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	1167
Urdhër i MF nr.12, datë 18.4.2006	Për miratimin e primit të pastër të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të	1168

treta.....

L I G J
Nr.9498, datë 3.4.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993 “PËR SIGURIMET
SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Shkronja “ç” e pikës 1 të nenit 74 ndryshohet si më poshtë:

“ç) propozon te Ministri i Financave ndryshimet në statusin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe në ligjin e sigurimeve shoqërore;”.

Neni 2

Në nenin 77 bëhen këto ndryshime:

a) Titulli bëhet “Marrëdhëniet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore me Ministrinë e Financave”.

b) Në pikën 1 fjalët “nëpërmjet Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale” zëvendësohen me fjalët “nëpërmjet Ministrisë së Financave”.

c) Në pikën 2 fjalët “do t’i paraqesë Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale” zëvendësohen me fjalët “do t’i paraqesë Ministrit të Financave”.

ç) Në pikën 3 emërtimi “Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale” zëvendësohet me emërtimin “Ministri i Financave”.

d) Në pikën 4 emërtimi “Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale” zëvendësohet me emërtimin “Ministria e Financave”.

Neni 3

Në nenin 78 fjalët “ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale” zëvendësohen me fjalët “ndërmjet Ministrisë së Financave”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4832, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9499, datë 3.4.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9121, DATË 28.7.2003 “PËR MBROJTJEN E
KONKURENCËS”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Shkronja “c” e nenit 20 “Kushtet për t’u zgjedhur anëtar i komisionit” ndryshohet si më poshtë:

“c) të jetë, prej jo më pak se 5 vjetësh, pjesëtar i trupit akademik universitar ose të mbajë titull apo gradë shkencore në fushën e ekonomisë a të drejtësisë, specialiteti “E drejtë civile/ administrative;”.

Neni 2

Shkronja “c” e pikës 3 të nenit 22 “Papajtueshmëritë dhe lirimi nga detyra i anëtarëve të komisionit” ndryshohet si më poshtë:

“c) mungon në detyrë mbi 1 muaj në mënyrë të pajustificuar;”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4833, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9506, datë 3.4.2006

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8626, DATË 22.6.2000 “PËR STATUSIN E
INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Shteti përjashton të sëmuret paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga pagesat për kontributet shëndetësore dhe u jep të drejtën e përfitimit falas të barnave, të mbuluara nga skema e sigurimeve të kujdesit shëndetësor.

Paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të cilët kanë përfituar statusin, përfitojnë një shtesë në të ardhura për mbulimin e shpenzimeve të paketës së domosdoshme me materiale të veçanta higjieno-sanitare. Masa, kriteret dhe procedura e përfitimit të kësaj shtese në të ardhura përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4840, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J **Nr.9507, datë 3.4.2006**

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9075, DATË 29.5.2003 “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TERMAVE Kryesorë të ZGJIDHJES SË BORXHIT TË JASHTËM TË TRASHËGUAR, TË PAPAGUAR TË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9075, datë 29.5.2003 “Për miratimin e kriterëve dhe termave kryesorë të zgjidhjes së borxhit të jashtëm të trashëguar, të papaguar të Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Shkronja "b" e pikës II të nenit 1 ndryshohet si më poshtë:

"b) për borxhin e jashtëm të trashëguar ndaj kreditorëve të tjerë, që nuk janë anëtarë të Klubit të Parisit, përdoret të paktën njëri nga kriteret e mëposhtme:".

Neni 2

Fjalja e dytë e pikës III "Afati i përfundimit të marrëveshjeve" të nenit 1 ndryshohet si më poshtë:

“Marrëveshjet dypalëshe për zgjidhjen e borxhit të jashtëm të përfundohen deri më 31.12.2007.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4841, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9508, datë 3.4.2006

PËR BASHKËPUNIMIN E PUBLIKUT NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të nxisë pjesëmarrjen e publikut në denoncimin e korrupsionit, duke mbrojtur e nxitur personat, të cilët denoncojnë praktikat korruptive të abuzimit me autoritetin publik.

Neni 2

Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, procedurave e përgjegjësiive të zbatueshme në institucionet shtetërore për denoncimin dhe regjistrimin e praktikave korruptive, si dhe shpërblimin e mbrojtjen e personave që denoncojnë.

Neni 3

Përkufizimet

Për qëllim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Institucion shtetëror" janë institucionet e administratës publike që pranojnë denoncimet sipas këtij ligji dhe që në buxhetin e tyre kanë fonde të dedikuara për shpërblimin, sipas shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji.

2. "Denoncim" është njoftimi i bërë pranë institucioneve shtetërore për praktika korruptive, që personat kanë zbuluar, gjetur dhe për të cilat kërkohet ose duhet t'i nënshtrohen kontrollit shtetëror.

3. "Person" është personi fizik ose juridik, vendas ose i huaj.

4. "Praktikë korruptive" është çdo veprim ose mosveprim, i kryer duke abuzuar me autoritetin publik, për sigurimin e përfitimeve të paligjshme për interesa privatë në dëm të interesave të shtetit apo të shtetasve.

Neni 4

Denoncimi

1. Denoncimi i praktikave korruptive bëhet pranë institucionit shtetëror, në administratën e të cilit pretendohet se janë kryer praktikat korruptive, ose në institucionin epror të tij. Denoncimi bëhet me gojë ose me shkrim, regjistrohet nga institucioni dhe trajtohet sipas rregullave të përcaktuara në

këtë ligj.

Denoncimet anonime trajtohen nga institucioni kryesisht, në të gjitha rastet kur ato përmbajnë të dhëna të besueshme për kryerjen e praktikave korruptive.

2. Denoncimet, ku nuk përcaktohet qartë zyrtari të cilit i paraqitet denoncimi, i dërgohen titullarit të institucionit shtetëror, i cili ngarkon autoritetin përgjegjës për shqyrtimin e denoncimit.

3. Kur denoncuesi lidh denoncimin e tij me kërkesën për shpërblim, kërkesa depozitohet bashkë me denoncimin. Formulari i kërkesës për shpërblim përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 5

Karakteri zyrtar

1. Denoncimet e kryera në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, si edhe çdo dokument tjetër që lidhet me to konsiderohen dokumente zyrtare.

2. Për mbrojtjen e këtij dokumentacioni nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë të ndryshojnë ose të asgjësojnë këtë dokumentacion, përgjigjen zyrtarët, të cilët përdorin, administrojnë ose i ruajnë ato. Kalimi i praktikës nga një zyrtar tek tjetri bëhet kundrejt nënshkrimit, që vërteton marrjen e dokumentacionit.

Neni 6

Konfidencialiteti dhe ruajtja e anonimatit

Zyrtarët publikë, që administrojnë dokumente ose fakte të denoncuara, sipas përcaktimeve të këtij ligji, zbatojnë parimet e konfidencialitetit dhe, kur kërkohet nga personi që denoncoi praktikën korruptive, sigurojnë ruajtjen e anonimatit të tij.

Neni 7

Mbrojtja për denoncimet e kryera

Institucionet shtetërore s'mund të nisin procedimin administrativ, civil ose penal për personin që ka kryer denoncimin edhe nëse ai rezulton i pavërtetë, me përjashtim të rastit kur ky person është punonjës i institucionit dhe me dashje ka paraqitur një denoncim për një praktikë, e cila është haptazi e ligjshme.

KREU II

PROCEDURA E SHQYRTIMIT TË DENONCIMIT

Neni 8

Regjistrimi i denoncimeve

1. Institucionet shtetërore janë të detyruara të kryejnë regjistrimin e denoncimeve të paraqitura në adresë të tyre. Për çdo denoncim hapet një dosje e veçantë administrative, përpara se ajo t'i dërgohet personit të cilit i adresohet ose titullarit të institucionit.

2. Rregullat e hollësishme për regjistrimin, dokumentimin, vlerësimin dhe transferimin e denoncimeve përcaktohen në rregulloren e brendshme të çdo institucioni.

Neni 9

Shqyrtimi i denoncimeve

1. Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin paraprak të denoncimit është zyrtari, të cilit i adresohet denoncimi, ose personi i caktuar sipas nenit 4 të këtij ligji.

2. Autoriteti përgjegjës për shqyrtim paraprak, pasi njihet me përmbajtjen e dosjes së denoncimit, urdhëron:

a) fillimin e hetimit administrativ për faktet, ngjarjet, rrethanat dhe personat e përmendur në denoncim dhe njoftimin e personit të denoncuar për njohjen e tij me materialet e denoncimit dhe hetimit administrativ. Në urdhrin për fillimin e hetimit administrativ duhet të caktohet personi ose

personat e ngarkuar me hetimin;

b) për mungesë kompetence, dërgimin e dosjes nëpunësit më të lartë të administratës së institucionit, për t'ia përcjellë për kompetencë institucionit, që ka lidhje me objektin e denoncimit;

c) dërgimin e dosjes nëpunësit më të lartë të administratës, për t'ia përcjellë organit të prokurorisë, kur çmon se denoncimi përmban të dhëna të mjaftueshme për fillimin e procedimit penal. Kallëzimi penal dhe depozitimi i tij bëhen në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”;

ç) mosfillimin e hetimit administrativ, kur denoncimi është i pabesueshëm, i një natyre të përgjithshme dhe i palidhur me rrethana konkrete, dukshëm i rremë ose i bërë me qëllim për të shmangur vëmendjen nga praktika korruptive. Urdhri për mosfillimin e hetimit shënohet në dosjen që përmban denoncimin, i arsyetuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në urdhrin për mosfillim të hetimit.

Neni 10

Hetimi administrativ i denoncimeve

1. Hetimi administrativ i denoncimeve bëhet në përputhje me ligjin nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, për aq sa ai është i zbatueshëm për hetimin e denoncimeve.

2. Hetimi administrativ u ngarkohet zyrtarëve, që disponojnë kompetencën dhe funksionet administrative, që lejojnë kryerjen e hetimit.

Neni 11

Përfundimi i hetimit

1. Hetimi administrativ përfundon me dorëzimin e raportit nga personi i ngarkuar me hetimin autoritetit përgjegjës, sipas këtij ligji. Raporti duhet të përmbajë shpjegime rreth fakteve dhe rrethanave të paraqitura, rezultatet e hetimit, si dhe shoqërohet me rekomandime për ndëshkimin e autorëve dhe masat për rivendosjen e së drejtës nëse nga hetimi rezulton se është shkelur ligji.

2. Në rastet kur denoncimi është i lidhur me kërkesën për shpërblim, raporti duhet të përmbajë edhe rekomandim për përfitim shpërblimi, sipas këtij ligji dhe llojin e shpërblimit.

Neni 12

Vendimi për rezultatet e hetimit

1. Pas dorëzimit të raportit nga personi i ngarkuar me hetim, autoriteti përgjegjës vendos për një ose disa nga veprimet e mëposhtme:

a) përgatitjen e kallëzimit penal, sipas nenit 281 të ligjit nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, kur konstatohet se ndodhet përpara kryerjes së një vepre penale;

b) fillimin ose paraqitjen e kërkesës për procedim disiplinor për autorët e praktikës korruptive, punonjës në institucion, kur konstatohen shkelje të ligjit gjatë ushtrimit të detyrës, që përbëjnë shkak për fillimin e procedimit disiplinor;

c) hartimin e raportit ose të kërkesës për hartim raporti për vlerësimin e dëmit ekonomiko-financiar, shkaktuar shtetit ose të tretëve, si dhe mënyrën e vjeljes së dëmit, kur konstatohet se mund të ketë dëm ekonomik ndaj shtetit;

ç) rekomandimin për dhënie shpërblimi për personin, që ka kryer denoncimin së bashku me arsyetimin për llojin e masës së shpërblimit të zbatueshëm;

d) shënimin që kërkesa për shpërblim të refuzohet së bashku me arsyetimin përkatës;

dh) kthimin e çështjes për hetim pranë të njëjtit person ose caktimin e një personi tjetër, kur konstaton se rrethanat e hetimit të çështjes janë të paplota dhe/ose merr dijeni për fakte dhe rrethana të reja, të cilat hedhin dritë për hetimin e çështjes;

e) mbylljen e hetimit, pasi denoncimi është i pambështetur në fakte dhe rrethana;

ë) miratimin ose jo të rekomandimeve të tjera të veçanta, që propozon personi i cili ka kryer hetimin.

2. Autoriteti përgjegjës në të gjitha rastet kur nuk është përcaktuar ndryshe, sipas këtij ligji,

arkivon dosjen dhe informon titullarin e institucionit, si dhe personin në ngarkim të të cilit është bërë denoncimi për përfundimet e çdo hetimi për denoncim.

Neni 13

Mbyllja e dosjes

Dosja e denoncimit nuk mund të arkivohet përpara se personi që ka bërë denoncimin, nuk ka përfituar shpërblimin sipas këtij ligji.

KREU III

SHPËRBLIMI I PUBLIKUT

Neni 14

Llojet e shpërblimit

1. Llojet e shpërblimit janë:

- a) shpërblim në masën nga 50 000 deri në 1 000 000 lekë;
- b) shpërblim sipas vlerës së gjobës së vënë kundërvajtësit;
- c) shpërblim deri në 6 për qind të vlerës së përfitimit të krijuar për shtetin, si pasojë e konfiskimit të produkteve të veprave penale korruptive, të rritjes së të ardhurave publike ose reduktimit të kostove publike, që kanë ardhur si pasojë e rivendosjes së të drejtës së shkelur.

2. Në zbatim të shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni, shpërblimi nuk mund të jetë më i madh se 50 për qind e vlerës së dëmit.

3. Kriteria të hollësishme për mënyrën e caktimit të masës së shpërblimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15

Kushtet për përfitim shpërblimi

1. Personat që denoncojnë praktika korruptive, kanë të drejtë të përfitojnë shpërblim monetar në përfundim të procesit të hetimit vetëm kur e kanë kërkuar atë sipas këtij ligji dhe kur në përfundim të procesit të hetimit denoncimi rezulton i bazuar, real dhe i panjohur më parë.

2. Nuk e përfiton këtë të drejtë personi i përfshirë në praktikë korruptive ose personi, i cili ka marrë dajeni për shkak të detyrës.

Neni 16

Caktimi i masës së shpërblimit

1. Shpërblimi për denoncim caktohet nga titullari i institucionit në bazë të rekomandimeve të autoritetit përgjegjës. Titullari përcakton llojin dhe mënyrën e shpërblimit. Urdhri për ekzekutimin e shpërblimit në lekë, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji, lëshohet nga titullari i institucionit që ka hetuar denoncimin.

2. Për shpërblime sipas shkronjave “b” e “c” të pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji ekzekutimi bëhet me urdhër të Ministrisë të Financave, pasi më parë ky i fundit i ka dhënë pëlqimin për caktimin e llojit të shpërblimit titullarit të institucionit që ka hetuar denoncimin.

3. Urdhri për dhënie shpërblimi, sipas këtij ligji, është titull ekzekutiv.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17

Dispozita kalimtare

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë fondet e nevojshme në buxhetet e institucioneve shtetërore për realizimin e qëllimit të këtij ligji.

2. Institucione shtetërore, në kuptim të këtij ligji, për vitin kalendarik 2006, do të

konsiderohen Këshilli i Ministrave dhe institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit ose ministrave.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të neneve 4 pika 3 dhe 14 pika 2, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4842, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9509, datë 3.4.2006

**PËR SHPALLJEN E MORATORIUMIT PËR MJETET MOTORIKE LUNDRUESE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Të gjitha lëvizjet e mjeteve motorike lundruese shqiptare në ujërat territoriale dhe të brendshme të Republikës së Shqipërisë, si dhe transporti i mjeteve lundruese në rrugë tokësore, me përjashtim të atyre të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji, pezullohen.

Neni 2

Afati i zbatimit të këtij ligji është 3 vjet nga data e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 3

Përjashtohen nga ky moratorium:

- a) mjetet motorike lundruese në përdorim të organeve shtetërore dhe të shërbimeve portuale;
- b) mjetet lundruese të destinuara vetëm për peshkim, sipas ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 "Për peshkimin dhe akuakulturën", të ndryshuar;
- c) mjetet e transportit detar, që shërbejnë për transportin e mallrave;
- ç) mjetet e transportit detar, të licencuara për transport pasagjerësh dhe të klasifikuara nga Regjistri Detar Shqiptar si mjete lundruese për transport udhëtarësh.

Neni 4

Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe kundërvajtësi dënohet me gjobë në masën 800 000 - 1 000 000 lekë dhe me konfiskim të mjetit.

Vendimi për masën administrative merret nga shefi i komisariatit të juridiksionit të konstatimit të shkeljes.

Kundër këtij vendimi, brenda 10 ditëve, bëhet ankim te drejtori i policisë së qarkut.

Neni 5

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 1 dhe 3 të tij.

Neni 6

Ngarkohen Policia e Shtetit dhe Roja Bregdetare për zbatimin e këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4843, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

DEKRET

Nr.4848, datë 21.4.2006

PËR DHËNIE TË SHTETËTËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik e Ministrit të Punëve të Jashtme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--|--|
| 1. Kurtali Hamit Llozana | 8. Giuseppe Angelo Inglese |
| 2. Xhafer Hisen Berisha | 9. Agron Ahmet Reqica |
| 3. Naser Adem Gjonbalaj | 10. Alirabi Rexhep Abdija |
| 4. Magbule Mustafë Mara (Rrahmani) | 11. Valdimir Tryggvi Valdimarsson Tryggvason |
| 5. Lulzim Hysen Gashi | 12. Antonio Rafeale Reano |
| 6. Gabriele Tito Florio | 13. Ernad Aliman Fejzullahu |
| 7. Olena Oleksandr Mykhaylenko-Zoto (Mihailjenko-Zoto) | 14. Martin Nosh Berishaj |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

URDHËR

Nr.12, datë 18.4.2006

PËR MIRATIMIN E PRIMIT TË PASTËR TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË MBAJTËSVE TË MJETEVE MOTORIKE PËR PËRGJEGJËSINE NDAJ PALËVE TË

TRETA

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr.7641, datë 1.12.1992 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.295, datë 15.09.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”, i ndryshuar, dhe të rregullores së datës 7.05.2002 “Për disa shtesa në rregulloren nr.622/1, datë 15.12.1992 “Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”, pas shqyrtimit të propozimit të Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve,

URDHËROJ:

1. Tarifat e primit të pastër për sigurimin e detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta për kontratat me afat njëvjeçar, të jenë si më poshtë:

Në lekë

Kat	Klasa	Tipi	Kapaciteti Motorik (cm ³) ose pesha bartëse (T) ose numuri i vendeve	Primi i Pastër (Minimal)	Primi i Pastër (Maksimal)
A 1		Motocikleta	Kapaciteti motorik		
	A 1/1		Deri në 150 cm ³	3.000	3.500
	A 1/2		Mbi 150 cm ³	5.000	6.000
B 1		Autovetura	Kapaciteti motorik		
	B 1/1		Deri në 1200 cm ³	5.500	7.500
	B 1/2		Mbi 1200 deri në 1800 cm ³	7.500	9.600
	B 1/3		Mbi 1800 deri në 2500 cm ³	9.600	11.000
	B 1/4		Mbi 2500 cm ³	11.000	15.000

Në lekë

Kat	Klasa	Tipi	Kapaciteti Motorik (cm ³) ose pesha bartëse (T) ose numuri i vendeve	Primi i Pastër (Minimal)	Primi i Pastër (Maksimal)
B 2		Furgona, mikrobuzë	Nr Vendeve		
	B 2/1		Nga 5 deri në 8 vende	13.000	20.000
	B 2/2		Mbi 8 deri në 15 vende	18.000	25.000
C 1		Autobusë	Mbi 15 vende	25.000	40.000
D 1		Kamioncina	Pesha mbajtëse (Ton)		
	D 1/1		Deri në 1 ton	12.000	15.000
	D 1/2		Mbi 1 deri në 2 ton	15.000	21.000
D 2		Kamionë	Pesha mbajtëse (Ton)		
	D 2/1		Mbi 2 deri në 5 ton	17.000	24.000
	D 2/2		Mbi 5 deri në 10 ton	19.000	28.000

	D 2/3		Mbi 10 deri në 15 ton	21.000	32.000
	D 2/4		Mbi 15 ton	25.000	40.000
E 1		Rimorkio	Pesha mbajtëse (Ton)		
	E 1/1		Deri 1 ton	3.000	3.500
	E 1/2		Mbi 1 ton	5.000	6.000
F		Mjete bujqësore		3,000	3.500
G		Zjarrfikëse		10.000	15.000

2. Shpenzimet që do t'i shtohen primit të pastër për sigurimin e detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta për kontratat me afat njëvjeçar nuk mund të jenë më pak se 20% e primit të pastër dhe më shumë se 25% të këtij primi.

3. Tarifat e primit të pastër për sigurimin e detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta për kontratat kufitare të jenë:

		Tarifat maksimale				
Kat	Tipi i mjetit	Primi ne EURO				
		15 ditë	20 ditë	25 ditë	30 ditë	45 ditë
A	Autovetura	17	21	24	28	31
B.1	Motoçikleta	8	10	12	14	17
B.2	Motokarro	10	14	17	21	24
C.1	Kamion për mallra nga 15 deri 34.99 Kv	56	70	84	91	105
C.2	Kamion për mallra nga 35 Kv e lartë	70	84	91	105	126
D	Ciklomotor	8	10	12	14	17
E	Autobusë	98	112	133	147	174
F.1	Rimorkio kamioni	42	49	56	63	77
F.2	Rimorkio Autobuzi	56	63	70	77	98
F.3	Rimorkio të tjera	21	28	35	42	49

Pas shtimit të shpenzimeve administrative, tarifat maksimale të primit janë jo me shumë se:

Tarifat maksimale

Kat	Tipi i mjetit	Primi ne EURO				
		15 ditë	20 ditë	25 ditë	30 dite	45 dite
A	Autovetura	44	52	61	70	78
B.1	Motoçikleta	21	26	30	35	44
B.2	Motokarro	26	35	44	52	61
C.1	Kamion për mallra nga 15 deri 34.99 Kv	140	174	209	227	262
C.2	Kamion për mallra nga 35 Kv e larte	174	209	227	262	314
D	Ciklomotor	21	26	30	35	44
E	Autobusë	244	279	331	366	436
F.1	Rimorkio kamioni	105	122	140	157	192
F.2	Rimorkio Autobuzi	140	157	174	192	244
F.3	Rimorkio të tjera	52	70	87	105	122

4. Shpenzimet administrative që do t'i shtohen primit të pastër për sigurimin e detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta për kontratat kufitare nuk mund të jenë më të ulta se 20% e primit.

5. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve miraton shpenzimet për çdo shoqëri sigurimi,

menjëherë me paraqitjen e planit të biznesit përkatës të miratuar nga Asambleja e Aksionarëve.

6. Primi minimal i arkëtuar nga shoqëritë e sigurimit për kontratat e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta është i barabartë me primin e pastër duke i shtuar shpenzimet minimale sipas pikave 2 dhe 4 të këtij urdhri.

7. Moszbatimi i tarifave të primeve, të përcaktuara në këtë urdhër, i bën shoqëritë e sigurimit subjekt të sanksioneve të përcaktuara në nenin 165- e vijues të ligjit nr.9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.

8. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit, Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve dhe Byroja Shqiptare e Sigurimit të marrin masat për zbatimin e këtij urdhri.

9. Urdhri i Ministrit të Financave nr.11, datë 25.03.2005 “Për miratimin e primit të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta” dhe të gjitha aktet e tjera të dala në zbatim të tij, shfuqizohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i fillon efektet nga data 1.5.2006.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan BODE

Kjo tabelë duhet t'i bashkëngjitet vendimit nr.172, datë 29.3.2006 të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.31/2006

Struktura	Kodi Zyres	Emertimi i postit	Katg	Nr			
Kabineti i DP	1000	Drejtor i Përgjithshëm	DP	1			
		Keshilltar i Përgjithshëm	A	2			
		Sekretar	C3	1			
		Shofer	D1	1			
		Shogerues	D1	1			
		Zyra e Shtypit dhe Marrëdhënieve me Publikun	B	2	8 Zyra DP		
Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë	1400	Drejtor	A	1			
		Specialist i marrëdhënieve ndërkombetare	C1	1			
		Përkthyes	C1	1	3 Marrëdhëniet me Jashtë		
Drejtoria e Kontrollit të Brendshëm	1500	Drejtor	A	1			
		Perpunuese Informacioni	C3	1			
	Sektori i kontrollit financiar	1510	Shef sektori	B	1		
			Inspektor kontrolli financiar	C1	2		
	Sektori kontrollit operacional	1520	Shef sektori	B	1		
			Inspektor kontrolli operacional	C1	6	12 Kontrolli Brendshëm	
Totali i kabinetit dhe drejtorive që varen nga Drejtori Përgjithshëm				DP	1		
				NDP	0		
				A	4		
				B	4		
				C1	10		
				C2	0		
				C3	2		
				D1	2		
				D2	0		
				23	23	Kabineti DP	
Departamenti Administrativ	1100	Shef departamenti	NDP	1			
		Sekretare	C3	1	2 Zyra NDP-Administrativ		
	Drejtoria e Organizim Personelit, Trainimit dhe Etikes	1110	Drejtor	A	1		
			Shef sektori personeli	B	1		
			Specialist personeli	C1	2		
		Sektori i menaxhimit te personelit	1111	Specialist Protokoll/Arshive	C1	1	
				Sekretare (Protokoll)	C3	2	
				Arkivist	C3	2	
	Sektori i trainimit	1113	Shef sektori trainimi	B	1		
			Specialist trainimi	C1	2		
	Sektori i Etikes	114	Përgjegjes i Sektorit te Etikes	B	1		
			Specialist	C1	1	14 Personeli & Trajnimi	
	Drejtoria e Finances	1140	Drejtor	A	1		
			Shef sektori buxheti	B	1		
		Sektori buxhetit	1141	Specialist buxheti	C1	1	
				Shef sektori finance kontabilitet	B	1	
				Specialiste	C1	2	
				Llogarite	C2	1	
	Sektori kontabilitetit	1142	Magaznier	D1	3		
			Punetor Magazine	D2	1	11 Financa	
	Drejtoria e Kompjuterizimit	1120	Drejtor i Teknologjise se Informacionit (TI)	A	1		
			Shef sektori mbeshtetjes IT	B	1		
		Sektori i Mbeshtetjes	1121	Specialist mbeshtetjet per IT	C1	3	
				Shef sektori i zhvillimit IT	B	1	
		Sektori Zhvillimit	1122	Specialiste Zhvillimi	C1	3	
				Shef Sektori Administrim Sistemi	B	1	
	Sektori Administrim Sistemi	1123	Specialiste	C1	5	15 Teknologjia Informacionit	
Drejtoria e Investimeve dhe Logjistikes			1130	Drejtor Logjistikes dhe investimeve	A	1	
	Shef sektori investimeve	B		1			
	Sektori investimeve	1131	Specialist investimesh	C1	2		
			Shef sektori logjistikes	B	1		
	Sektori logjistikes	1132	Specialist logjistike	C1	3		
			Teknik mirembajtje	D1	5		
Teknik centrali			D1	1			
Fumitor			D1	1			
Shofer			D1	12			
Pastruese			D2	3			
Njesia prokurimit	1133	Shef sektori	B	1			
		Specialiste	C1	2	33 Investime & Logjistike		
Totali i Departamentit Administrativ				DP	0		
				NDP	1		
				A	4		
				B	11		
				C1	27		
				C2	1		
				C3	9		
				D1	22		
				D2	4		
				75	75	Totali Dep. Administrativ	

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT.....	1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT.....	2000

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI DOGANOR.....	1000
3. KODI DETAR	1000

Hyri në shtyp më 27.4.2006
 Doli nga shtypi më 2.5.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
 Tiranë, 2006

Çmimi 100 lekë